



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.134 dt.05.08.1997

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.05.08.1997, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Ndërtim Strehimit “Mbi organizimin e N.Sh.K.Banesa dhe financimin e saj”, në zbatim të ligjit Nr.7572, dt.10.05.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal” dhe vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.27/1, dt.14.02.1997.

VENDOSI

I. Të miratojë strukturën organizative të Ndërmarrjes Shërbimeve Komunale Banesa si më poshtë :

Tirana do të grupohet në 3-zona të cilat do mbulojnë përkatësisht :

Zona I	Njësitë Administrative	Nr.1-2-3-4
Zona II	Njësitë Administrative	Nr.5-6-7
Zona III	Njësitë Administrative	Nr.8-9-10-11

Çdo zonë do ketë një përgjegjës, një teknik (specialist) dhe brigadën e punës, përbërë nga 2 punëtore për çdo Njësi Administrative.

Pra Zona e I – 8 punëtorë, Zona e II – 6 punëtorë, Zona e III – 8 punëtorë.

Administrata

1.Drejtor	1
2.Dega teknike	2
3.Dega e financës	2
4.Juriste	1
5.Sekretare daktilografiste	1
6.Dega e furnizimit	1
7.Përgjegjës zone	3
8.Magazinier	2
9.Përgjegjës urgjence	1
10. <u>Teknik (specialist zone)</u>	<u>3</u>
SHUMA	17 veta

Punëtorë Buxhetore

1.Punëtorë pranë zonave	22
-------------------------	----

2.Punëtorë urgjence	6
3.Shofer	4
4.Roje	3
5.Punëtorë transporti	3
<u>SHUMA</u>	<u>41 veta</u>
GJITHSEJ	58 veta

1.Hazis Marku	(Drejtori i Nd.Gjelbërimit)
2.Shaban Ceni	(kryeinxhinier)
3.Jolanda Mitrushi	(kryetare e degës ekonomike)
4.Miranda Cika	(inxhinierë pyjesh)
5.Beniamin Meqemeja	(inxhinier mekanik)

- II.** Për aktivitetin e Ndërmarrjes konform strukturës organizative të saj të miratojë fondet si më poshtë :

Fonde operative(VJETORE)

1.Për pagat e punonjësve	4.830.000 lekë
2.Për sigurimet shoqërore(34.2%)	1.652.000 lekë
3.Për materiale emrgjente	<u>2.000.000 lekë</u>
SHUMA	8.482.000 lekë

Fonde investimesh

1.Për blerje pompash për largim uji nga vend – strehimi	300.000 lekë
2.Për blerje automjeti vet – ngritës	1.500.000 lekë
3.Për blerje moto – karro për urgjencë	300.000 lekë
4.Për aparat matrapik	200.000 lekë
5.Për aparat saldimi	<u>200.000 lekë</u>
SHUMA	2.500.000 lekë

- III.** Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Ndërtim Strehimit.

- IV.** Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI